



“NY State of Health” lidh njujorkezët me sigurim shëndetësor të përballeshëm

Ne ju ndihmojmë të krahasoni planet shëndetësore dhe të gjeni mbulimin e duhur për veten dhe familjen tuaj.

“NY State of Health” ofron plane me prim të ulët ose pa prim, shërbime parandaluese falas, asnjë bashkëpagesë për kujdesin parësor dhe receta me kosto të ulët. Ndhima financiare federale e zgjeruar ofrohet për të ulur kostot e sigurimit shëndetësor për më shumë njujorkezë.

PROGRAMET PËRFSHIJNË:

- 1 Medicaid
- 2 Child Health Plus
- 3 Essential Plan
- 4 Qualified Health Plans

Kur të regjistrohni, mbani gati këto informacione për gjithë anëtarët e familjes suaj:

- ✓ Datëlindjet
- ✓ Numrat e sigurimeve shoqërore ose, për emigrantët e ligjshëm, numrat e dokumenteve nëse janë të disponueshëm
- ✓ Informacion mbi punësimin, të ardhurat dhe sigurimin shëndetësor të sponsorizuar nga punëdhënësi

Na kontaktoni për t'u regjistruar ose për të mësuar më shumë:

- Vizitoni nystateofhealth.ny.gov
- Telefononi 1-855-355-5777 (TTY: 1-800-662-1220)
- Merrni ndihmë falas nga një asistent për regjistrim. Gjeni një asistent në adresën <https://info.nystateofhealth.ny.gov/findassistor>

Informacion për të regjistruarit

Nëse jeni të regjistruar për sigurim shëndetësor nëpërmjet “NY State of Health”, ruajeni lidhjen në mënyrë që të mos humbisni përditësime të rëndësishme, duke përfshirë kohën e rinovimit të mbulimit.

- 1** Regjistrohuni për njoftime me mesazh. Për t'u abonuar, dërgoni mesazhin START në numrin 1-866-988-0327
- 2** Përditësoni informacionin e llogarisë tuaj. Sigurohuni që “NY State of Health” ka adresën postare, numrin e telefonit dhe adresën aktuale të emailit në mënyrë që ne të mund t'ju kontaktojmë për sigurimin tuaj shëndetësor.
 - Telefononi 1-855-355-5777 (TTY: 1-800-662-1220)
 - Identifikohuni në llogarinë tuaj në nystateofhealth.ny.gov
 - Kontaktoni një asistent për regjistrim. Gjeni një asistent në adresën <https://info.nystateofhealth.ny.gov/findassistor/>
- 3** Kur të njoftoheni nga “NY State of Health”, është koha të veproni për sigurimin tuaj shëndetësor. Kontrolloni kutinë hyrëse të emailit dhe kutinë postare për informacion dhe njoftime të rëndësishme. Ndiqni udhëzimet dhe rinovoni mbulimin brenda afatit të dhënë.

**JEMI KËTU PËR T'JU NDIHMUAR!
NA KONTAKTONI NËSE KENI PYETJE.**

“NY State of Health” pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, besimit/fesë, gjinisë, moshës, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.